

D E K R E T
Nr.1143, datë 3.7.1995

PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TOKËSORË TË VEPRIMTARISË SË GJYKATAVE
USHTARAKE

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1992 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" dhe të nenit 6 të ligjit nr.7574, datë 24.6.1992 "Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile", me propozim të ministrit të Drejtësisë,

D E K R E T O J

Neni 1

Kufijtë territorialë të veprimtarisë së gjykatave ushtarake të shkallës së parë të jenë si më poshtë:

1. Gjykata ushtarake e Tiranës, me qendër në Tiranë, e cila do të shtrijë veprimtarinë edhe në rrethet Kavajë, Durrës, Krujë, Kurbin, Mirditë, Mat, Bulqizë dhe Dibër.
2. Gjykata ushtarake e Shkodrës, me qendër në Shkodër, e cila do të shtrijë veprimtarinë edhe në rrethet Malësi e Madhe, Tropojë, Kukës, Has, Pukë e Lezhë.
3. Gjykata ushtarake e Vlorës, me qendër në Vlorë, e cila do të shtrijë veprimtarinë edhe në rrethet Fier, Lushnjë, Berat, Kuçovë, Skrapar e Mallakastër.
4. Gjykata ushtarake e Korçës me qendër në Korçë, e cila do të shtrijë veprimtarinë edhe në rrethet Devoll, Kolonjë, Pogradec, Librazhd, Elbasan, Peqin e Gramsh.
5. Gjykata ushtarake e Gjirokastrës, me qendër në Gjirokastrë, e cila do të shtrijë veprimtarinë edhe në rrethet Tepelenë, Përmet, Sarandë e Delvinë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI

Sali Berisha

Miratuar me ligjin nr.7976, datë 26.7.1995 të Kuvendit Popullor